



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 392/3 Prot.

Tiranë, më 24/5/2013

REKOMANDIM

Nr. 07 datë 24/05 2013

Mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr. 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr. 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit "Drejtoria e Përgjithshme e Doganave" Tiranë.

KONSTATOVA

Në zbatim të urdhërit nr. 72 datë 12/04/2013 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u ushtrua kontrolli administrativ pranë kontrolluesit "Drejtoria e Përgjithshme e Doganave" Tiranë. Ky kontroll administrativ u fillua kryesisht nga Komisioneri dhe kontrolluesi u njoftua paraprakisht për ushtrimin e këtij kontrolli.

Objekti i kontrollit administrativ ishte:

- Zbatimi i udhëzimit nr 3 datë 05.03.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera".

Grupi i kontrollit administrativ:

- U njoh dhe shqyrtoi dokumentacionin e kontrolluesit.
- Intervistoi dhe mori deklarime nga përfaqësues të kontrolluesit.
- Inspektoi ambientet e kontrolluesit.
- Administroi me cilësinë e provës në funksion të kontrollit administrativ, dokumente shkresore lidhur me funksionimin e sistemit të "Kamerave Vëzhgim-Regjistrimit".

Gjatë kontrollit administrativ janë krijuar kushte për ushtrimin e tij, përfaqësuesit e kontrolluesit u treguan bashkëpunues në të gjitha fazat e ushtrimit të kontrollit administrativ, si dhe vendosen në dispozicion të grupit të kontrollit të gjitha materialet dhe dokumentet shkresore të kërkuara.

Kontrolluesi "Drejtoria e Përgjithshme e Doganave" Tiranë ka instaluar dhe përdor për mbikëqyrje dhe regjistrim sistemin e "Kamerave Vëzhgim-Regjistrimi" në ambientet e 20 Degëve Doganore të shpërndara në të gjithë territorin e Shqipërisë. Qëllimi i përdorimit të sistemit të "Kamerave Vëzhgim-Regjistrimi" i cili kryen përpunim e imazheve të cilat janë të

dhëna personale me karakter të veçantë fizik është "parandalimi, zbulimi dhe ndëshkimi i tregtisë të paligjshme dhe kontrabandës së mallrave, mbrojtja e shëndetit publik, mbrojtja e konsumatorit dhe ambientit, evidentimi i shkeljeve të kodit të etikës nga ana e personelit doganor, siguria e punonjësve dhe e pronës së administratës doganore".

Konceptimi dhe instalimi i këtij sistemi është pjesë e projektit "Suport për implementimin e sistemit dixhital të survejimit me kamera për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Policinë Kufitare Shqiptare" të hartuar dhe financuar nga Bashkimi Evropian ku DPD është përfituesi.

Kontrolluesi DPD ka hartuar Udhëzimin nr. 02 datë 14/02/2013: "Për monitorimin, regjistrimin dhe administrimin e të dhënave të sistemit të kamerave", ku parashikon metodën e punës dhe procedurat standarde të monitorimit, regjistrimit, transmetimit dhe administrimit të pamjeve nëpërmjet Sistemit të Monitorimit me Kamera të vendosura në Degët Doganore të kësaj administrate. Rregullat që duhet të ndiqen gjatë përdorimit të këtij sistemi në Degët Doganore. Udhëzimi është në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar si dhe Udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 "Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera" i ndryshuar, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Të dhënat personale duhet të përpunohen duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në veçanti e drejta e ruajtjes së jetës private, të drejta këto të mbrojtura nga neni 8 i Konventës Evropiane për "Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut" dhe ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se zbatimi i Udhëzimit nr. 02 datë 14/02/2013: "Për monitorimin, regjistrimin dhe administrimin e të dhënave të sistemit të kamerave", nuk është i plotë, në kontrollin administrativ në Degën e Doganës Vlorë u konstatua mungesa e tabelave të informimit për publikun për përdorimin e sistemin e "Kamerave Vëzhgim-Regjistrimi", si dhe mungesa e Udhëzimit mbi përdorimin e sistemit të "Kamerave Vëzhgim-Regjistrimi".

Zbatimi i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar si dhe Udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 "Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera" i ndryshuar, konsiston në respektimin e informimit të subjekteve të të dhënave personale për përdorimin e sistemit të "Kamerave Vëzhgim-Regjistrimi", respektimin e kohës për ruajtjen e regjistrimeve, të drejtën për akses vetëm për persona të caktuar, mbrojtjen e materialeve të regjistruara, përdorimin e materialeve të regjistruara në rastet kur kërkohen të përdoren nga organet e përcaktuara me ligj, ruajtjen e konfidencialitetit dhe sigurisë për të dhënat që mbliidhen nga ky sistem. Kërkesë shumë e rëndësishme është respektimi i të drejtave të subjekteve të të dhënave personale të cilëve u përpunohen të dhënat nga përdorimi i këtij sistemi në përputhje me nenet 12-17 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se kontrolluesi "Drejtoria e Përgjithshme e Doganave" Tiranë si organi i cili administron sistemin e "Kamerave Vëzhgim-Regjistrimi" në të gjithë rrjetin doganor në Shqipëri duhet të dërgojë menjëherë Udhëzimin nr.2 datë 14.02.2013 "Për monitorimin, regjistrimin dhe administrimin e të dhënave të sistemit të kamerave", në të gjitha Degët Doganore ku ka vendosur këtë sistem, si dhe t'u kërkojë drejtuesve të këtyre Degëve të respektojnë kërkesat e ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 "Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera" i ndryshuar, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative ;

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 3, datë 05.03.2010 "Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera" i ndryshuar, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të merren masa që të respektohen kërkesat ligjore lidhur me:
 - Zbatimin e Udhëzimit nr.2 datë 14.02.2013 "Për monitorimin, regjistrimin dhe administrimin e të dhënave të sistemit të kamerave", i Drejtorisë të Përgjithshme të Doganave në të gjitha Degët Doganore ku është vendosur ky sistem;
 - Vendosjen e tabelave për informimin e subjekteve të të dhënave personale për përdorimin e sistemit të "Kamerave Vëzhgim-Regjistrimi";
 - Respektimin e kohës për ruajtjen e regjistrimeve;
 - Respektimin e të drejtës për akses;
 - Administrimin e materialeve të regjistruara;
 - Zbatimin e procedurave ligjore për përdorimin e materialeve të regjistruara në rastet kur kërkohen nga organet e përcaktuara me ligj;
 - Ruajtjen e konfidencialitetit dhe sigurisë për të dhënat që mblidhen nga ky sistem;
 - Respektimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave personale të cilëve u përpunohen të dhënat nga përdorimi i këtij sistemi.
2. Për plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
3. Në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, sipas të cilit... "Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave".

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

